



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për :	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Goran Rakić, Zëvendëskryeministër dhe Ministër në MPL Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MPL	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave	Datë: 21.12.2020 Nr. 020- 989
Zyrtarët përgjegjës		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Sanije Dërguti, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të komunës së Lipjanit	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimin 15Nr.463-60377 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Lipjan
I miratuar më datë: 14.12.2020
I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 15.12.2020

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimi 15Nr.463-60377 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Lipjan	Ministria e Financave përmes shkresës 020—599/3 të datës 28.08.2020 ka njoftuar MPL, se shërbyesit civil ose zyrtari i një autoriteti publik ose organizatës buxhetore, nëse kryen ndonjë shërbim shtesë brenda organizatës buxhetore ku punon, nuk ka të drejtë të pranojë, kurfar kompenzimi shtesë për këtë shërbim. Të bashkangjitur e gjeni raportin nga MF, për komunën e Kaçanikut ku trajtohet kompenzimi i komisioneve.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Za:	Imri Ahmeti, gradonačelnik opštine Lipljan Daut Azemi, predsedavajuća Skupštine opštine Lipljan	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MLS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini,	
Preko:	Goran Rakić, zamenik premijera i ministar MLS, Trim Berisha, zamenik generalnog sekretara MLS,	
Od:	Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MLS	Datum, 21.12.2020 br. 020-989
Odgovorni službenik za utvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
Službenik-ca za izradu pravne procene:	Sanije Dërguti, viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Zahtev za reviziju zakonitosti akta opštine Lipljan	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Uvaženi gradonačelnice,
Uvažena predsedavajuća,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 06/2020 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MLU, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka 15 br.463-60377 o osnivanju komisije za procenu sprovođenja postupaka za davanje na kratkoročnu upotrebu nepokretne opštinske imovine KZ Lipjan

Usvojena dana, 14.12.2020godine,

Predložen za razmatranje u MLS, dana, 15.12.2020

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore pomenutog akta, **ocenjuje da je opštinski akt u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.**

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

Br.	Formulisanje u aktu opštine	Zakonska odredba sa kojom je akt opštine u suprotnosti.
1.	Odluka 15 br.463-60377 o osnivanju komisije za procenu sprovođenja postupaka za davanje na kratkoročnu upotrebu nepokretne opštinske imovine KZ Lipjan	Ministarstvo finansija putem spisa 020 – 599 / 3 od 28. avgusta 2020.godine, obavestila je MLS da državni službenik ili službenik javnog organa ili budžetske organizacije, ukoliko obavi bilo koju dodatnu uslugu u okviru budžetske organizacije u kojoj radi, nema pravo na nikakvu dodatnu nadoknadu za ovu uslugu. Priloženo će te pronaći izveštaj MF-a, za opštinu Kačanik, gde se obrađuje nadoknada komisija.

Iz gore navedenog, Ministarstvo lokalne samouprave **zahteva** od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine preduzimanje konkretnih delatnosti kako bi akt opštine uskladile sa zakonskim odredbama na snazi, unutar predviđenog roka od 30 dana, od dana prijema zahteva za reviziju akta.

Ministarstvo lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za daljnja objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kryetari i Komunes propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, nenit 17 të Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2020, të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK LIPJAN

Neni 1

Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronave së paluajtshme të komunës- lokaleve afariste për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr. _____ i datës _____ (në vazhdim të tekstit: Komisioni në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, prej të cilëve 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga përbërja e ekzekutivit të Komunës, 2 (dy) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet politike dhe 1 (një) anëtar nga sektori jo qeveritar lokal.

2. Anëtarë të Komisionit emërohen, si vijon :

1. Bekim Shabani, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim nga ekzekutivi i Komunës
2. Nazim Gashi, Drejtor i Drejtoratit për Mbrojtje dhe Shpëtim nga ekzekutivi i Komunës
3. _____ nga subjektet politike
4. _____ nga subjektet politike
5. Denis Gashi nga sektori joqeveritar lokal

Vendimi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01. Nr. 060/01-18351/20 për kompensimin e komisioneve të kuvendit të komunës,

I miratuar me datë: 12.08.2020.

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë : 14.08.2020.

I dërguar për shqyrtim në MF me datë: 18.08.2020.

Në shqyrtimin e përmbajtjesor të aktit, Ministria e Financave vlerëson se të gjitha kompensimet shtesë të kenë parasysh nenin 80 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë të Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, neni 80, citon:

"Nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, sipas një akti të qeverisë, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik, ky punonjës, shërbyes civil ose zyrtar nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim".

Po ashtu, neni 81 i Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë të Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, citon:

"Në rast mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, që kanë të bëjnë me menaxhimin e parasë publike, dispozitat e ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, do të kenë përparësi..."

Andaj, bazuar në dispozitat ligjore të lartë cekura, kompensimi shtesë për punonjësit, shërbyesit civil dhe zyrtarët publik të angazhuar në komisione apo në trupa të ndryshme, është i ndaluar me nenin 80 të LMFP-së. Pra, ky kufizim vlen vetëm për kategorinë që caktohet në nenin 80 të LMFP-së dhe vendimi në këtë kontekst nuk është i ligjshëm. Në anën tjetër, kompensimi i anëtarëve të jashtëm nuk ka kufizime të tilla dhe duhet të bëhet nga kategoria e duhur ekonomike e shpenzimeve.

Ministria e Financave sugjeron Komunën e Kaçanikut që të shqyrtojë forma të tjera të punës së këtyre komisioneve, që mund të kompensohen sipas Rregullores Nr. 33/2012 për shtesa në pagë dhe kompensime tjera të nëpunësve civil.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, nenit 17 të Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 14.12.2020, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK LIPJAN

Neni 1
Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronave së paluajtshme të komunës- lokaleve afariste për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr. 463-60371 i datës 14.12.20 (në vazhdim të tekstit: Komisioni në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, prej të cilëve 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga përbërja e ekzekutivit të Komunës, 2 (dy) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet politike dhe 1 (një) anëtar nga sektori jo qeveritar lokal.

2. Anëtarë të Komisionit emërohen, si vijon :

1. Bekim Shabani, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim nga ekzekutivi i Komunës
2. Nazim Gashi, Drejtor i Drejtoratit për Mbrojtje dhe Shpëtim nga ekzekutivi i Komunës
3. Majlinda Sylejmani, nga subjektet politike
4. Nazmi Krasniqi, nga subjektet politike
5. Denis Gashi nga sektori joqeveritar lokal

Neni 2
Zgjedhja e Kryesuesit

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave, e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit i cili e kryeson punën e Komisionit.

Neni 3

Mandati i anëtarëve

Manadati i anëtarëve të Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15-463-6037 të datës 14.12.2020.

Neni 4

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni, për të zbatuar Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës të cekur më lartë me të cilin është vendos për pronën e cila do jepet në shfrytëzim, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nëligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Zyra Kryetarit të Komunës -- Sektori pronësor-juridik.

Neni 6

Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Njoftimi publik do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

15 Nr. - 463-60377

Lipjan, më 14.12..2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

Na osnovu člana 12 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040, Službena Novina Republike Kosova br.28 dt. 4 juni 2008, člana 17 Zakona Br.06/L-092 za davanje na korišćenju i menjanju Opštinskog nepokretnu imovinu, Službena Novina Republike Kosova br.10 dt. 03 april 2019, člana 17 Uredba QRK Br.09/2020 za određivanje procedure o davanje na korišćenju i menjanju Opštinskog nepokretnu imovinu kao i člana 20 Statuta Opštine Lipljan 1Br.110-623 dt. 26.09.2008, Skupština Opštine na održanoj sednici dana 14.12.2020, nakon razmatranja predloga Odluka Predsednika Opštine usvojio:

ODLUKA

ZA OSNIVANJE KOMISIJE ZA PROCENJIVANJE ZA SPROVOĐENJE PROCEDURA O DAVANJE NA KRATKOROČNO KORIŠĆENJU OPŠTINSKOG NEPOKRETNOSTI IMOVINU KZ LIPLJAN

Član 1

Sastav Komisije

1. Osniva se Komisija procenivanja za sprovođenje procedura o davanje na kratkoročno korišćenju Opštinskog nepokretnu imovinu-- poslovni prostor za prethodnu Odluku za davanje na kratkoročno korišćenju Opštinskog nepokretnu imovinu 15Br. 463-60371 i dt. 14.12.20 (u nastavku teksta: Komisija u sastavu od 5 (pet) članovi, od koji 2 (dva) predloženi članovi od Predsednika Opštine od izvršni sastav Opštine, 2 (dva) članovi od Skupštine Opštine iz politički subjekti i 1 (jedan) član od nevladni lokalni sektor.

2. Članovi Komisije imenuju se, kao što sledi:

1. Bekim Shabani, Direktor za Ekonomiju i Razvoj od Opštinskog izvršni
2. Nazim Gashi, Direktor Direkcije za Zaštitu i Spasavne od Opštinskog izvršni
3. Majlinda Sylejmani, iz politički subjekta
4. Nazmi Krasniqi, iz politički subjekta
5. Denis Gashi od nevladni lokalni sektor

Član 2

Izbor Predsedavajućeg

Članovi Komisije većinom glasova, izabere predsedavajućeg Komisije koji predsedava radom komisije

Član 3 Mandat članova

Mandat članova Komisije je privremena i određiva za sprovođenje procedure za davanje na kratkoročno korišćenje nepokretne imovine Opštine za prethodnu Odluku o davanju na kratkoročno korišćenje nepokretne imovinu Opštine 463-60371 dt. 14.12.2020.

Član 4 Zadaci i odgovornosti Komisije

Komisija, da sprovede gore pomenutu prethodnu odluku Skupštine Opštine koja je odlučila o imovini koja se daje na korišćenje, odgovoran je za sprovođenje procedure predviđenih odredbama zakona Br.06/L-092 za davanje na kratkoročno korišćenje i menjenu nepokretnu imovinu Opštine i Uredbe QRK Br.09/2020 za utvrđivanje procedure za davanje na kratkoročno korišćenje i menjenu nepokretnu imovinu Opštine.

Član 5 Administrativno-pravni poslovi Komisije

Komisija će u realizaciji zadataka definisanih Zakonom podzakonskim aktima i ovom odlukom pomagati u okviru svojih nadležnosti Kancelarija Predsednika Opštine imovinsko-pravni sektor.

Član 6 Naknada za rad Komisije

Članovi Komisije za svoj rad na sprovođenju postupaka za ocenu ponuda Javnog obaveštenja biće nadoknađeni u iznosu nadoknade, koja se plaća za prisustvo sastanku članovima Odbora za Politiku i Finansije.

Član 7 Stupanje na snagu

Ova Odluka stupa na snagu 7 dana nakon objavljivanja na web sajtu Opštine.

Br.15- 463-60371
Lipljan 14.12.2020

SKUPŠTINA OPŠTINE LIPLJAN

Predsedavajući Skupštine
Daut Azemi



Neni 2
Zgjedhja e Kryesuesit

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave, e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit i cili e kryeson punën e Komisionit.

Neni 3
Mandati i anëtarëve

Manadati i anëtarëve të Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës _____ të datës _____.

Neni 4
Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni, për të zbatuar Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës të cekur më lartë me të cilin është vendos për pronën e cila do jepet në shfrytëzim, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5
Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nëligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Zyra Kryetarit të Komunës – Sektori pronësor-juridik.

Neni 6
Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Njoftimi publik do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Arsyetim

Baza juridike

Baza juridike për të propozuar Vendimin është e përcaktuar me dispozitat e nenit 58 shkronja h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 40 shkronja h.) e Statutit të Komunës së Lipjanit.

Baza juridike dhe obligimi ligjor për të miratuar këtë Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i dates 26.09.2008.

Komisioni vlerësues formohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr. _____ të datës _____ konform nenit 17 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me të cilin nen përcaktohet që për secilin vendim paraprak të Kuvendit të Komunës formohet komisioni vlerësues.

Anëtari i pestë i Komisionit nga subjekti joqeveritar lokal është zgjedhur përmes shpalljes publike.

Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr. _____ i datës _____ përmban paluajtshmëritë në pronësi të Komunës – lokalet afariste të cilat gjenden në ZK Lipjan në rrugën "Lidhja e Prizrenit" me destinim për zhvillimin e aktiviteteve të biznesit.

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

INr. 463 - 58653

Lipjan, 02.12.2020

KRYETARI KOMUNES

Imir Ahmeti



Mimoza S. Morina

From: Sanije Dërguti
Sent: Tuesday, December 29, 2020 1:29 PM
To: Behar Aliu; Haqif Shillova; Daut Azemi
Cc: Imri Ahmeti; Venera Çerkini; Xhevat Tafa; Mimoza S. Morina; Aurora Kadriu
Subject: Njoftim.....

Të nderuar,

Ju njoftoj lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së **Vendimit 15Nr.463-60377** për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Lipjan, dhe **Vendimin Paraprak 15Nr.463-60371** për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës, ju lutem të mos ndërmerrni veprime për të publikuar në ueb faqe të komunës, për të krijuar efekte deri në njoftim nga MPL-ja.

Me respekt!
Sanije Dërguti